

MP BALKAN sh.p.k.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-18

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,361	715,336
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	-	391,103
Inventari	6	-	104,837
Total aktive afatshkurtra		3,361	1,211,276
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	265,045	285,877
Total aktive afatgjata		265,045	285,877
Total aktive		268,406	1,497,153
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	8	4,327	-
Llogari të pagueshme tregtare	9	-	359,967
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	10	3,309,343	2,970,169
Detyrime tatimore	11	-	77,329
Të tjera detyrime	12	-	237,095
Total detyrime afatshkurtra		3,313,670	3,644,560
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		3,313,670	3,644,560
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	13	10,000	10,000
Rezerva të tjera		(2,157,407)	(619,589)
Fitimi/humbja e vitit		(897,857)	(1,537,818)
Total kapitali		(3,045,264)	(2,147,407)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		268,406	1,497,153

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	2,649,167	3,030,220
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	48,422	4,321
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,606,108)	(1,953,821)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	16	(1,063,610)	(1,383,856)
2) Të tjera shpenzime	17	(542,498)	(569,965)
Shpenzime të personelit	18	(1,932,284)	(2,550,763)
1) Paga dhe shpërblime		(1,678,598)	(2,203,291)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(253,686)	(347,472)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(40,465)	(64,807)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(10,258)	-
Shpenzime financiare	19	(6,331)	(2,968)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,011)	(324)
2) Shpenzime të tjera financiare		(5,320)	(2,644)
Fitimi/humbja para tatimit		(897,857)	(1,537,818)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20		
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(897,857)	(1,537,818)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(897,857)	(1,537,818)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MP BALKAN sh.p.k.


(Vlerat janë në Lekë)


**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim/humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	10,000	(455,007)	(164,582)	(609,589)
Fitimi/humbja e vitit	-	-	(1,537,818)	(1,537,818)
Lëvizjet përmes kapitalit	-	(164,582)	164,582	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	10,000	(619,589)	(1,537,818)	(2,147,407)
Fitimi/humbja e vitit	-	-	(897,857)	(897,857)
Lëvizjet përmes kapitalit	-	(1,537,818)	1,537,818	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	10,000	(2,157,407)	(897,857)	(3,045,264)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga 4im ëdstrator I MP Balkan Sh.P.K. më 21 mars 2022 dhe janë firmosur si më poshtë:


Z. Mario Caruggi
Administrator


Mazars Shpk

Mazars Shpk

Mazars Hapjes | Pasqyrave Financiare

mazars
Emin Duraku Str., Binjakët Build.,
No.5, 1018, Tirana, Albania
NUIŠ: K32123006W

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim/humbja e vitit	(897,857)	(1,537,818)
Shpenzimet financiare jomonetare	11,103	1,132
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	40,465	64,807
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	391,103	(332,297)
Rënie/(rritje) në inventarë	104,837	(104,837)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(127,932)	729,245
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(146,807)	(64,535)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(625,088)	(1,244,303)
Fluksi I Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(19,633)	(350,683)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(19,633)	(350,683)
Fluksi I Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi I kapitalit të nënshkruar	-	-
Hua të arkëtuara	(116,465)	2,258,739
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(116,465)	2,258,739
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(761,186)	663,753
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	715,336	46,201
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	49,211	5,382
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 3,361	715,336

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “ MP BALKAN” sh.p.k. është themeluar më 03 maj 2018 dhe është regjistruar më 07 maj 2018 në Regjistrin e Shoqërive me akt themelimi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është projektimi, ndërtimi, instalimi, funksionimi dhe menaxhimi i impianteve të prodhimit të energjisë nga çdo burim, si dhe ofrimin e shërbimeve të integruara për ndërtimin dhe menaxhimin e mundshëm të masave për reduktimin e konsumit dhe si përfundim çdo aktivitet tjetër lidhur me ndërhyrjet në fushën e shërbimeve dhe kursimin e energjisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Mario Caruggi.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L81707023A. Selia qendrore e saj është në: Bulevardi "Bajram Curri", Qendra ETC, Kati 10, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2021 ishte 3 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe performancës të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e periudhës së raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro/LEK	120.76	123.7
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e performancës. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën performancës çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e performancës janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e performancës.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e performancës nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e periudhës së raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të periudhës së raportimit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike.

Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare	3,361	715,336
Llogari rrjedhëse ne bankë	3,361	715,336
	<u>3,361</u>	<u>715,336</u>

5. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogaritë të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
TVSH e kreditueshme	-	44,743
Garanci qira zyre	-	346,360
	<u>-</u>	<u>391,103</u>

6. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Materiale të para	-	104,837
	<u>-</u>	<u>104,837</u>

7. Aktive afatgjata materiale

	<u>Mobilje dhe orendi</u>	<u>Paisje kompjuterike</u>	<u>Të tjera</u>	<u>Totali</u>
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2020	-	-	-	-
Shtesa	310,350	13,334	27,000	350,684
Gjendja më 31 dhjetor 2020	310,350	13,334	27,000	350,684
Shtesa	-	19,633	-	19,633
Gjendja më 31 dhjetor 2021	310,350	32,967	27,000	370,317
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2020	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	(56,813)	(3,051)	(4,943)	(64,807)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(56,813)	(3,051)	(4,943)	(64,807)
Amortizimi i vitit	(33,759)	(3,769)	(2,937)	(40,465)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	(90,572)	(6,820)	(7,880)	(105,272)
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 1 janar 2020	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	253,537	10,283	22,057	285,877
Gjendja më 31 dhjetor 2021	219,778	26,147	19,120	265,045

8. Hua afatshkurtra

Llogaritë e huave afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Overdraft	4,327	-
	<u>4,327</u>	<u>-</u>

9. Llogari të pagueshme tregëtare

Llogaritë e pagueshme tregëtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Furnitorë vendas	-	359,967
	<u>-</u>	<u>359,967</u>

10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Financim nga ortaku	2,306,519	2,362,670
Te pagueshme tregtare	193,431	195,077
Financime nga Mario Caruggi	410,695	412,422
Financime nga Spahiu Gjanc	332,280	-
Financime nga Hidro Invest	66,418	-
	<u>3,309,343</u>	<u>2,970,169</u>

11. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	-	40,573
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	-	16,438
Tatim në burim	-	20,318
	<u>-</u>	<u>77,329</u>

12. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Pagat e punonjësve	-	146,810
Të tjera detyrime ndaj Mazars Shpk	-	19,776
Financime të tjera	-	70,509
	<u>-</u>	<u>237,095</u>

13. Kapitali

Kapitali i shoqërisë MP BALKAN sh.p.k. është 10.000 lekë më 31 dhjetor 2021.

Humbja e shoqërisë për vitin 2021 është 897.857 Lekë (2020: 1,537.818 Lekë).

14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Të ardhura nga shitja e konsulencave	2,649,167	3,030,220
	<u>2,649,167</u>	<u>3,030,220</u>

15. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(19,185)	(21,720)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	67,607	26,041
	<u>48,422</u>	<u>4,321</u>

(Vlerat janë në Lekë)

15. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	2,649,167
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	2,649,167
Shërbime	2,649,167
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	2,649,167
Fitim nga këmbimet valutore	67,607
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit	2,716,774

16. Materiale të para dhe të konsumueshme

Materiale të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Materiale te para	104,837	-
Shpenzime qiraje	955,856	1,288,678
Shërbime konsulence	-	57,840
Konsumi inventari imët	2,917	36,585
Kancelari	-	753
	1,063,610	1,383,856

17. Të tjera shpenzime

Shpenzimet të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime konsulence ekonomike	245,884	350,624
Shpenzime për dieta	100,932	37,179
Shërbime administrimi dhe sigurie	99,285	-
Taksa vendore	51,500	51,500
Shpenzime bankare	44,127	59,066
Furnizim uje rrjeti	770	-
Transport për personelin	-	41,476
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	20,800
Qira makine	-	7,320
Shpenzime administrative	-	2,000
	542,498	569,965

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime për paga	1,678,598	2,203,291
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	253,686	347,472
	<u>1,932,284</u>	<u>2,550,763</u>

19. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime për interesa	(1,011)	(324)
Humbje nga këmbimet valutore financiare	(5,320)	(2,644)
	<u>(6,331)</u>	<u>(2,968)</u>

20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Fitimi/(humbja) para tatimit	(897,857)	(1,537,818)
Shpenzime të panjohura të tjera	185,656	150,989
Shpenzime pritje dhe përcjellje	-	11,709
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	-	78,655
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	10,258	-
Shpenzime qiraje sipas referencës	46,094	60,625
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	129,304	-
Fitimi/(humbja) para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(712,201)	(1,386,829)
Tatim fitimi 15%	-	-
	<u>(897,857)</u>	<u>(1,537,818)</u>

21. Transaksione me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
INTER-TRADE INVEST SARL	2,306,519	2,362,670
Sunvolt Sh.P.K.	193,431	195,077
Mario Caruggi	410,695	412,422
Spahiu Gjanc Sh.P.K	332,280	-
Hidro Invest Sh.P.K	66,418	-
	3,309,343	2,970,169

Pasqyra e performancës

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje nga palët e lidhura		
Sunvolt Sh.P.K.	-	195,212
	-	195,212

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shitje drejt palët e lidhura		
MP Power Srl	1,398,570	2,035,935
Spahiu Gjanc Sh.P.K	1,100,244	-
	2,498,814	2,035,935

22. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palët e treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

23. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së periudhës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.